

# Pandemic EBT

## Prindi / Kujdestari Pyetjet e Bëra më Shpesh

### Kualifikimi

#### 1. Çfarë është Transferimi Pandemik Elektronik i Përfitimeve (P-EBT)?

- P-EBT ofron përfitime shtesë të ndihmës ushqimore për studentët që kanë humbur përkohësisht akses në vaktet shkollore falas ose me çmim të ulur për shkak të pandemisë COVID-19. Qëllimi i programit është të sigurohemi që asnjë student nuk do të ketë uri duke humbur vaktet e shkollës.

#### 2. A kualifikohet studenti im për Transferim Pandemik Elektronik të Përfitimeve (P-EBT)?

- Kualifikimi fillon nëse studenti ishte:
  - I regjistruar në një shkollë që plotësoi dhe dorëzoi prapun 5-ditor dhe llojin e pjesëmarrjes në Portalin e Raportimit të Kualifikimit P-EBT **DHE**
  - I regjistruar për të marrë vakte falas ose të reduktuara të drekës në shkollën e tyre (përfshirë studentë të çertifikuar dhe shkolla CEP) **DHE**
  - Nuk mori mesime personalisht (in-person) për disa ose për të gjithë muajin **OSE**
  - Ne qofte se mesim in-person vaktet nuk i janë dhene dhe nuk ke ngrënë në shkollë gjatë ditës së mesimit.

#### 3. Disa distrikte shkollore kualifikohen për një Shërbim të Kualifikimit të Komunitetit (CEP) ku janë të gjithë nxënësit të kualifikuar për vakte falas, pavarësisht nga të ardhurat. A janë ata studentë të përshtatshëm për P-EBT?

- Nxënësit në një shkollë CEP janë të kualifikuar ne qofte se shkolla plotëson prapun 5-ditor dhe studenti merr mesim të reduktuar personalisht (in-person).

#### 4. A kualifikohen studentët e Programit Pre-K, Head Start, ose Great Readiness Program?

- Dy programet pre-k që mund të kenë studentë që kualifikohen për P-EBT janë Headstart dhe GSRP. Megjithatë, studenti i Headstart dhe GSRP ende duhet të plotësojnë Kualifikimin për Vaktet me Çmim të Reduktuar dhe Falas (Free and Reduced- Price Meal Eligibility) dhe kërkesat e modalitetit të të mësuarit.

#### 5. A kualifikohen studentët e Kolegjit të Hershëm ( Early College students) për P-EBT?

- Po, studentët në Programet e Kolegjit të Hershem mund të kualifikohen ne qofte se plotësojnë Kualifikimin për Vaktet me Çmim të Reduktuar dhe Falas (Free and Reduced- Price Meal Eligibility) dhe kërkesat e modalitetit të të mësuarit.

#### 6. Ne marrim vaktet "Grab-and-Go" nga shkolla. A kualifikohemi për P-EBT?

- Grab and Go janë falas për të gjithë studentët. P-EBT është përcaktuar në pyetjen 2. Marrja e vaktit ose dreka "Grab and-Go" nuk ndikojnë në kualifikimin e P-EBT.

#### 7. Studenti im merr drekë falas tani, a kualifikohen për P-EBT?

- Po, studenti mund të kualifikohet për P-EBT ne qofte se plotëson Kualifikimin për Vaktet me Çmim të Reduktuar dhe Falas (Free and Reduced- Price Meal Eligibility) dhe kërkesat e modalitetit të të mësuarit.

#### 8. A duhet të aplikoj për P-EBT?

- Jo, nuk ka asnjë proces aplikimi. MDHHS dhe MDE po punojnë drejtpërdrejt me distriktet e shkollave për të marrë informacion që lejon lëshimin e drejtpërdrejtë të përfitimeve për studentët e kualifikuar.

#### 9. A duhet të aplikoj përsëri çdo muaj?

- Jo, kualifikimi për këto përfitime përcaktohet automatikisht.

## 10. Si mund ta di nëse studenti im do të marrë P-EBT?

- Ne parashikojmë që cikli i parë i leshimit të fillojë në mes të marsit. Ne qofte se nuk merrni përfitime deri ne mes të prillit dhe studenti juaj ishte i kualifikuar per vaktet falas ose me cmim te reduktuar dhe kishte nje metode mesimi pjeserisht virtual ose plotësisht virtual, kontaktoni P-EBT.

## Përfitimet dhe Informacioni i Pagesës

### 1. Si do të marr përfitime P-EBT?

- Çdo student i kualifikuar per Asistence Ushqimore do të marrë përfitimet e tij P-EBT në atë karte EBT / Bridge Card.
- Të gjithë studentët e tjerë të kualifikuar do të marrin P-EBT Card në postë. Një kartë e veçantë do te dergohet per secilin student te kualifikuar.
- Nëse studenti është aktiv në një çështje per Medicaid, karta do të postohet në adresën qe eshte ne ajo ceshtje. Sigurohuni që të mbani adresën tuaj update me MDHHS dhe shkollën tuaj.

### 2. Nëse prindërit nuk jetojnë së bashku, cila familje merr P-EBT?

- Nëse studenti juaj është aktiv për përfitime ushqimore ose mjekësore me MDHHS, përfitimet do të leshohen në adresën e çështjes aktive. Nëse nuk ka asnjë adresë në një ceshtje aktive MDHHS, karta do të dërgohet në adresën që aktualisht është në dosjet e MDE për studentin. Sigurohuni që ta mbani adresen tuaj update si me MDHHS ashtu edhe me shkollën tuaj.

### 3. Cilët muaj përfshin programi P-EBT?

- Shtator 2020 deri në Qershor 2021.

### 4. Kur do të ngarkohet karta ime?

- Përfitimet pritet të fillojnë të leshohen në fund të Marsit. Një njoftim do të dërgohet me më shumë informacion.

### 5. Sa do te marr ne P-EBT?

- Kjo varet nga lloji i mesimit që student ka marre cdo muaj. Grafiku më poshtë përshkruan shumën e mundshme të përfitimit bazuar në llojin e mesimit për çdo muaj.

Plotesisht personalisht (in-person)	Asnje perfitim
Personalisht dhe on-line	Perfitim I pjesshem
Plotesisht on-line	Perfitim I plote

### 6. Po sikur të merrja vetëm një pagesë të pjesshme ose asnje pagesë për një muaj?

- PAGESA bazohet në mënyrën se si studenti ndoqi mësimet për muajin. Prindërit / Kujdestarët mund të paraqesin një formular rishikimi nëse ata mund të verifikojnë që shuma e marrë nuk përputhet me llojin mesimit të studentit. Formulari i rishikimit te P-EBT është në faqen e internetit të Departamentit të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore të Miçiganit ose duke kontaktuar MDHHS përmes postës elektronike në [MDHHS-PEBT@michigan.gov](mailto:MDHHS-PEBT@michigan.gov)

### 7. Si mund ta kontrolloj bilancin ose aktivitetin tim?

- Telefononi në numrin e shërbimit të klientit EBT 888-678-8914 ose ne link: [www.connectebt.com/miebtclient](http://www.connectebt.com/miebtclient)

### 8. Për sa kohë duhet të përdor paratë e mia P-EBT?

- Karta duhet të përdoret së paku një herë në një vit, përndryshe përfitimet do të hiqen.

## Pyetje ne lidhje me karten

### 1. A do të marr një kartë të re P-EBT megjithese kam pasur nje karte me perpara?

- Po. Kartat e kaluara P-EBT nuk do të përdoren përsëri. Mbani mend, nëse studenti juaj tani ka Ndhmë Ushqimore aktive, paratë e tyre P-EBT do të ngarkohen në Bridge Card të familjes.

## **2. Kam humbur kartën time. A do te kem nje zevendesim?**

- Kontaktoni një përfaqësues të shërbimit të klientit pa pagesë në 888-678-8914. Numri falas i Shërbimit të Klientit është në dispozicion 24 orë në ditë, 7 ditë në javë që ju të kërkonin një kartë zëvendësimi. Karta e zëvendësuar do të postohet brenda 3 deri në 5 ditë pune. Ju nuk do të duhet ta aktivizoni këtë kartë. Kodi PIN që keni përdorur në kartën tuaj të vjetër do të funksionojë me kartën tuaj të re. Pasi të porosisni një kartë zëvendësimi, karta juaj e vjetër nuk do të funksionojë më.

## **3. Si mund ta aktivizoj kartën time?**

- Telefononi në numrin në pjesën e pasme të kartës: 888-678-8914 dhe ndiqni udhëzimet për të aktivizuar një kartë të pullave ushqimore. Përdorni datën e lindjes së emrit të studentit në kartë. Përdorni "0000" (katër zero) për numrin e sigurimeve shoqërore.

## **4. Si ta përdor kartën time P-EBT? Çfarë mund të blej? Ku mund ta përdor kartën time P-EBT?**

Karta P-EBT përdoret në të njëjtën mënyrë si një kartë tradicionale EBT ose "Bridge Card". Ju lutemi vizitoni <https://www.fns.usda.gov/snap/eligible-food-items> për më shumë informacion.

## **5. Kam marrë një kartë për një student që nuk është në shtëpinë time. Cfare duhet te bej?**

- Shënoni në zarfin si "Jo në këtë adresë" (Not at this address) dhe kthejeni kartën tek dërguesi.

## **Ndihme ne lidhje me adresen**

### **1. A mund ta dërgoj kartën time diku tjetër?**

- Jo. Në situatat kur një kartë postohet, ajo do të shkojë te adresa Medicaid e studentëve ose adresa e shkollës së dhënë.

### **2. A mund të dërgohen kartat në kutitë PO (PO Boxes)?**

- Po.

### **3. Unë vendosa percjelljen e postës me zyren postale. A do të marr kartën time P-EBT?**

- Jo. Karta P-EBT NUK do të përcillet. Për të marrë një kartë zëvendësimi duhet të update adresën tuaj me shkollën. Nëse studenti është në Medicaid, sigurohuni që adresa juaj të update me Departamentin e Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore. Ju do të duhet të kontaktoni qendrën e thirrjeve të shërbimit të klientit PEBT dhe ata do të punojnë me ju për të lëshuar një kartë të re.

### **4. Çfarë duhet të bëj nëse shkoj në një adresë të re?**

- Update menjëherë adresën tuaj në shkollë dhe me MDHHS nëse studenti juaj ka ndihmë ushqimore.

### **5. A ka ndonjë afat për të update adresën time me shkollën?**

- Nuk ka afat për të update informacionin e adresave me shkollat lokale. Kurdoherë që ka ndonjë ndryshim në adresë, shkolla juaj duhet të njoftohet.